



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE VLORË

SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 417 prot.

Vlorë, më/6.7.2025

Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik.

SHPLLJE VENDI VAKANT

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 163, datë 28.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë shpall konkursin për pozicionin e punës:

PUNËTOR MIRËMBAJTJE NË SEKTORIN E HIMARËS

Kategoria e pagës, KLASA III

Përshkrimi i përgjithshëm i punës, për pozicionin si më sipër, është:

- Pozicioni i punës është në Kalanë e Porto Palermos, Sektori Himarë, Bashkia Himarë;
- Realizimi i punimeve koherente në Kalanë e Porto Palermos, si: shitje biletash për vizitorët vendas dhe të huaj, heqje vegjitacioni, pastrime, punë mirëmbajtëse etj., **si dhe në Kalanë e Himarës (nëse do të kërkohet prej Institucionit).**

Kriteret e përgjithshme:

- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm (**arsimi i lartë përbën përparësi në përzgjedhje**);
- Të ketë aftësi të mira komunikimi;
- Të komunikoj në gjuhën Angleze (**+njohja e gjuhëve të tjera përbën përparësi në përzgjedhje**);
- Të mos jetë në ndjekje penale nga ana e organeve të prokurorisë apo gjykatës;
- Të jetë i aftë për punë (raport për aftësi në punë);
- Të jetë banor i Bashkisë Himarë.

Kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dorazi ose në rrugë postare, pranë Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë, dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Kerkesë për punësim për pozicionin e punës;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës së arsimit të mesëm e njehsuar me origjinalin dhe/ose **(fotokopje e diplomës së arsimit të lartë e njehsuar me origjinalin, nëse ka përfunduar studimet e arsimit të lartë)**;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar, të dorëzohet në zyrën e protokollit të D.R.T.K – Vlorë, gjatë ditëve zyrtare të punës, nga dita e Hënë deri ditën e Enjte, ora 8:00 – 16:30, si dhe ditën e Premte, ora 8:00 - 14:00.

Afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit, do të jetë ditën e Martë, datë 29.07.2025, ora 16:30.

Ky njoftim për shpallje, i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik për publikim.

DREJTOR

Orgest FEIMI

